

# TFR

## Të zgjedhësh **sot** Duke menduar për **nesër**

Sot punonjësit mund të zgjedhin edhe kontributet shoqërore plotësuese, për të siguruar një pension të përshtatshëm kur të jenë pensionistë.

TFR (ose likuidimi) është pjesë e rrogës që mbahet nga punëdhënësi për t'iu dhënë punonjësit në përfundim të raportit të punës. Çdo vit vihet mënjanë 6,91% e pagës vjetore, dhe rivlerësohet gjithë çka është vënë mënjanë vitet pararendëse. Rivlerësimi është i barabartë me 1,5% plus 75% të rritjes së çmimeve për konsum sipas ISTAT-it.

Nga 1 janari 2007 çdo punonjës i varur, me përjashtim të bashkëpunëtorëve familjarë, mund të zgjedhë nëse dëshiron t'ia kushtojë TFR-n e vet të ardhshëm formave të pensionit plotësues, apo ta mbajë pranë punëdhënësit.

Për punonjësit e punësuar para 31 dhjetorit 2006, afati i zgjedhjes skadon më 30 qershor 2007; ndërsa të punësuarit nga 1 janari 2007 kanë gjashtë muaj kohë nga çasti i punësimit.

Zgjedhja mbi fatin e TFR-s mund të bëhet duke përpiluar formularët TFR1 e TFR2 (zgjedhja e hapur) të bashkëngjitur dekretit të Ministrisë së punës së datës 30 janar 2007. Punonjësi duhet t'ij përpilojë, t'ij nënshkruajë dhe t'ia dorëzojë punëdhënësit. Nëse nuk e bën një gjë të tillë, automatikisht zgjedhja shkon për fondet e paracaktuara të pensioneve (vlen parimi heshtje miratim).

Nëse punonjësi dëshiron të mbajë TFR-n pranë ndërmarrjes, në ato me më pak se 50 punonjës të varur, gjithçka mbetet si më parë; në ndërmarrjet me më shumë se 50 punonjës të varur TFR që lihet në ndërmarrje i shkon një Fondi të Thesarit pranë INPS-it me të gjitha karakteristikat e mëparshme përsa i përket rivlerësimit dhe paradhënieve të mundshme.

### **Duhet kujtuar**

Vënia e TFR-s në një formë pensioni plotësues, qoftë në mënyrë të hapur qoftë me heshtje, ka të bëjë vetëm me TFR-n e ardhshëm.

Formularët TFR1 dhe TFR2 janë të bashkëngjitur me dekretin e Ministrisë së punës së datës 30 janar 2007 dhe mund të gjenden në faqet internet [www.tfr.gov.it](http://www.tfr.gov.it).

**Për informacione të mëtejshme**

Numri i gjelbër: 800.196.196

[www.tfr.gov.it](http://www.tfr.gov.it)

[www.lavoro.gov.it](http://www.lavoro.gov.it)

[www.covip.it](http://www.covip.it)

[www.inps.it](http://www.inps.it)